

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____. _____. 2026

NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare);
Adresa Rruga "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë;
Tel/Faks +355 42 228 349, +355 42 239 295;
E-mail info@kesh.al;
Ueb-faqe www.kesh.al;

2. **Lloji i procedurës së prokurimit:** Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar me mjete elektronike – shërbime.

3. **Numri i referencës së procedurës /Lotit:** Nr.REF-93429-07-14-2026

4. **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** "Shërbim i transportit "Outsource i plotë", punonjësit Hec Fierzë".

5. **Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Shërbime te tjera-98390000-3**

6. **Fondi limit:** 37,060,020 (Tridhjetë e shtatë milion e gjashtëdhjetë mijë e njëzet) lekë pa TVSH ose 395,391 (Treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e një) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 14.07.2026 është 93.73 Lekë/Euro

7. **Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:** 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj.

8. **Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:** Data 05.08.2026, Ora:10:00

Bazuar në nenin 42, pika 6, të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", lidhur me shkurtimin e afateve, kërkohet shkurtimi i periudhës së pritjes në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) për procedurën e prokurimit me objekt: "**Shërbim i transportit "Outsource i plotë", punonjësit HEC Fierzë**", me qëllim garantimin e vazhdimësisë së shërbimit dhe shmangien e çdo ndërprerjeje të tij.

Kontrata aktuale për këtë shërbim është në përfundim të afatit të zbatimit. Duke marrë në konsideratë kohën e nevojshme për zhvillimin e procedurës së prokurimit, vlerësimin e ofertave, përfundimin e periudhës së ankimit (nëse paraqiten ankesa), lidhjen e kontratës dhe mobilizimin e operatorit ekonomik fitues, rezulton se respektimi i afateve standarde të publikimit mund të sjellë

pamundësinë e lidhjes së kontratës së re në kohë, duke rrezikuar ndërprerjen e një shërbimi të domosdoshëm për veprimtarinë e Autoritetit Kontraktor.

Shërbimi i transportit për punonjësit e HEC Fierzë përbën një shërbim mbështetës me rëndësi të veçantë për garantimin e vijimësisë së aktivitetit të përditshëm të centralit. Duke qenë se objekti ndodhet në një zonë ku transporti publik nuk garanton lëvizjen e rregullt të punonjësve sipas orareve të punës, ndërprerja e këtij shërbimi do të ndikonte drejtpërdrejt në organizimin e proceseve të punës, paraqitjen në kohë të personelit dhe mbarëvajtjen e operimit të objektit.

Moslidhja në kohë e kontratës së re mund të krijojë vështirësi në sigurimin e transportit të punonjësve, duke ndikuar negativisht në realizimin e detyrave operacionale, në vazhdimësinë e procesit të punës dhe në përmbushjen e objektivave të Autoritetit Kontraktor.

Shkurtimi i afatit të publikimit nuk synon në asnjë rast kufizimin e konkurrencës apo cenimin e parimeve të transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Dokumentet e tenderit janë hartuar në mënyrë të plotë, të qartë dhe pa kriterë diskriminues, duke u krijuar operatorëve ekonomikë mundësi reale dhe të mjaftueshme për përgatitjen dhe paraqitjen e ofertave.

Për sa më sipër, dhe duke qenë se ekzistojnë rrethana objektive që justifikojnë përsheptimin e procedurës, kërkohet që periudha e pritjes në SPE të shkurtohet nga **35 (tridhjetë e pesë)** ditë në **22 (njëzet e dy)** ditë, në përputhje me nenin 42, pika 6, të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së pandërprerë të shërbimit të transportit për punonjësit e HEC Fierzë, mbrojtjen e interesit publik dhe sigurimin e funksionimit normal të aktivitetit të Autoritetit Kontraktor.

9. Procedurë e Rishpallur:

Po



Jo

X